



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.743/15

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, trupi gjykues në përbërje nga gjyqtari Arsim Hamzaj - kryetari i trupit gjykues dhe gjyqtarëve porotë Adnan Zhëllta dhe Sejfullah Qesko - anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kujtesa Uka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit - të kundërpaditurit G. G. nga Prizreni, kundër të paditurve - kundërpaditësve Z. G. dhe B. G., të cilët me autorizim e përfaqëson av. R. B. nga Prizreni, për shkak të ndryshimit të pajtimit gjyqësor - zvogëlimit të alimentacionit dhe objekt të kundërpadisë rritjen e alimentacionit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik, me datën 06.06.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit - të kundërpaditurit G. G. nga Prizreni.

II. NDRYSHOHET Pajtimi Gjyqësor C.nr.514/10, i datës 22.09.2010 si në vijim:

- Obligohet paditësi - i kundërpadituri G. G. nga Prizreni, që në emër të alimentacionit - ushqimisë për fëmijët t'ia paguajë të paditurit - kundërpaditësit B. G. nga Prizreni shumën prej 50 euro në muaj, e cila pagesë do të bëhet për çdo muaj, e më së voni gjer me datën 5 të muajit rrjedhës, deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- Obligohet paditësi - i kundërpadituri G. G. nga Prizreni, që në emër të alimentacionit - ushqimisë për fëmijët t'ia paguajë të paditurit - kundërpaditësit Z. G. nga Prizreni shumën prej 50 euro në muaj, e cila pagesë do të bëhet për çdo muaj, e më së voni gjer me datën 5 të muajit rrjedhës, deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit - të kundërpaditurit G. G. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të ndërpritet pagesa e alimentacionit - ushqimisë për të paditurën - kundërpaditësen Z. G., **refuzohet si tërësisht e pa bazuar.**

IV. REFUZOHET kërkesa nga kundërpadia e të paditurve - kundërpaditësve B. dhe Z. G., të dy nga Prizreni përmes së cilës kanë kërkuar që të ndryshohet pajtimi gjyqësor C.nr.514/10, i datës 22.09.2010, i arritur në mes të paditësve Z. dhe B. G. me të paditurin G. G., ashtu që të obligohet paditësi G. G. të paguajë alimentacionin për fëmijët Z. dhe B. G. në shumë prej nga 150 euro në muaj, duke filluar nga dita e parashtrimit të kërkesëpadisë, **si tërësisht e pa bazuar.**

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi - i kundërpadituri G. G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurve - kundërpaditësve Z. G. dhe B. G., të cilët me autorizim e përfaqëson av.R. B. nga Prizreni, për shkak të ndryshimit të pajtimit gjyqësor - zvogëlimit të alimentacionit. Në padi ka cekur se me të paditurit, të cilët i përfaqëson e ëma e tyre S. M., me date 22.09.2010, ka arritur pajtim gjyqësor C.nr.514/10, me të cilin atëherë i padituri G. G. është pajtuar që në emër të ushqimisë për fëmijët e mitur Z. dhe B. G., për secilin të paguajë nga nga 75 euro në muaj duke filluar nga data 12.07.2010 deri në ndryshimin e rrethanave. Duke qenë se ka ardhur deri te ndryshimi i rrethanave ndërmjet pjesëmarrësve të pajtimit, pasi që paditësi në ndërkohë ka lidhur matesë të re nga e cila ka fëmijë, e poashtu fakt i ri edhe vajza Z. G. tani është e moshës së madhore dhe ka përfunduar studimet. Pasi që sipas nenit 290 të Ligjit për Familjen të dy prindërit janë të obliguar për përkujdesjen e fëmijëve, e në rastin konkret duke marrë parasysht kushtet ekonomike të të dy prindërve jep të shihet se paditësi nuk është në gjendje të jepë mbajtje në shumën siç është në pajtim sepse vjen në rrezik mbajtja e familjes së vet në masa të kuptueshme, e që është shkak që gjykata ta ndryshojë pajtimin gjyqësor, ashtu që të bie vendim me të cilin do të ulet alimentacioni për të miturin B. G. dhe të ndërpritet alimentacioni për tani madhoren, sepse janë plotësuar kushtet ligjore për këtë gjë. Andaj nga të lartcekurat ka propozuar që gjykata pas administrimit të provave ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit ashtu që ta ndryshojë pajtimin gjyqësor dhe ta zvoglojë alimentacionin për të paditurin B. G. në shumë prej 50 euro, ndërsa për të paditurën Z. G. të ndërpritet alimentacioni.

Edhe gjatë shqyrtimit kryesor, paditësi - i kundërpadituri ka ngelur në tërësi si në padi dhe kërkesëpadi, ndërsa në fjalën e tij të fundit i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar si dhe refuzimin e kërkesës nga kundërpadia si të pa bazë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por të njëjtat nuk i ka specifikuar.

Përmes përgjigjes në padi të paditurit e kanë kundërshtuar kërkesëpadisnë e paditësit, duke propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë, e poashtu të njëjtit kanë parashtruar kundërpadi, përmes të cilës kanë kërkuar që të ndryshohet pajtimi gjyqësor C.nr.514/10, i datës 22.09.2010, i arritur në mes të paditësve Z. dhe B. G. me të paditurin G. G., ashtu që të obligohet paditësi G. G. të paguajë alimentacionin për fëmijët Z. dhe B. G. në shumë prej nga 150 euro në muaj, duke filluar nga dita e parashtrimit të kërkesëpadisë

Në seancën e shqyrtimit kryesor, i autorizuari i të paditurve - kundërpaditësve av. R. B., ka mbetur në tërësi si në përgjigje në padi dhe kundërpadi, ndërsa në fjalën e tij të fundit ka

theksuar se nga data e arritjes së pajtimit gjyqësor e deri më tash kanë ndryshuar rrethanat në atë mënyrë që nevoja për ushqimin e fëmijëve është rritur me vet faktin e shpenzimeve me arritjen e moshës madhore të fëmijëve dhe nevojave për arsimim. Të pa baza janë theksimet në padi se shpenzimet e paditësit janë rritur, për shkak se nga martesë tjetër ka dy fëmijë, sepse edhe në kohën e arritjes së pajtimit gjyqësor i njeiti ka pasur dy fëmijë nga martesë tjetër. Shuma nga pajtimi gjyqësor është shumë e vogël në krahasim me nevojat e fëmijëve ushqimmarrës. Kundërpaditësja Z. është duke i ndjekur studimet për master në Turqi ndërsa kundërpaditësi B. është duke i ndjekur studimet në AUK në Prishtinë. Nëna e tyre për çdo njërin nga këta paguan nga 300 euro në muaj dhe realizon të ardhurat siç është vërtetuar në këtë procedurë. Me shumë vështirësi arrin ti mbulon shpenzimet e fëmijëve ushqimmarrës. Duke pasur parasysh moshën e fëmijëve dhe që ka i kundërpadituri nga martesë tjetër dhe nevojat e tyre, konsiderojmë se në bazë të të ardhurave që realizon i njëjti ka mundësi që të kontribuon në lartësi të shumës siç është kërkuar me kundërpadi. Përndryshe në bazë të ligjit të familjes prindi ka detyrim të kontribuon për ushqimin e fëmijëve të tij edhe në dëm të ushqimit të vet. Pavarësisht faktit se të paditurit nuk kanë mundur të sigurojnë prova lidhur me të ardhura tjera që i siguron paditësi përveç atyre nga marrëdhënia e punës së rregullt, jam i bindur se ai realizon edhe të ardhura tjera por nuk dëshiron ti paraqes ato. Në kontributin për ushqimin e fëmijëve sipas ligjit të familjes gjithsesi llogaritet edhe përkujdesja dhe ushqimi në formë tjera të prindit të i cili janë fëmijët, përkatësisht me të cilin jetojnë. Nga të cekurat i ka propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit dhe aprovimin e kërkesës nga kundërpadia. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, me qëllim të mosdëmtimit të njëres apo palës tjetër për ushqimin e fëmijëve.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat si në vijim: Pajtimin gjyqësor me nr.C.nr.514/10, të datës 22.09.2010, të aritur në mes këtu palëve ndërgjyqëse; Aktemërimin për G. G., të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, të datës 02.06.2015; Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e personelit – Komuna e Prizrenit, të datës 01.07.2016; Pasqyrën bankare të lëshuar na Pro Credit Bank, për G. G. nga Prizreni; Pasqyrën bankare për paditësin G. G. të lëshuar nga Pro Credit Bank dhe NLB Prishtina; Vërtetimin e lëshuar nga zyra e personelit Komuna e Prizrenit të dt.15.03.2016; Lejeqëndrimin të lëshuar nga Republika e Turqisë për të paditurën – kundërpaditësen Z. G.; Dokumentet e regjistrimit si dhe dokumentacionin për pagesën e semestrit dhe konviktit të lëshuar nga Hacettepe University – R. e Turqisë për të paditurën Z. G.; Transaksionet e llogarisë të lëshuar banka TEB në Prizren, për S. M. G.; Aktemërimin të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, për S. M. të dt.25.04.2012; Vërtetimin të lëshuar në A.U.K – R.I.T në emër të B. G., të datës 16.12.2015; Dëftesën e lëshuar nga “Mehmet Akif Koligj” për T. G., të datës 11.06.2015 si dhe Raportin e Qendrës për Punë Sociale në Prizren, nr.403, të datës 31.05.2016

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpapia e paditësit - të kundërpaditurit G. G., është pjesërisht e bazuar.

Kërkesa nga kundërpadia e të paditurve - kundërpaditësve është e pa bazuar

Nga leximi i Pajtimin gjyqësor me nr.C.nr.514/10, të datës 22.09.2010, gjykata ka konstatuar se në mes të këtu palëve ndërgjyqëse është arritur pajtimi gjyqësor për ushqiminë në shumën prej 150 euro në muaj.

Nga leximi i Aktemërimit për G. G., të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, të datës 02.06.2015, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi është i punësuar pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike si zyrtar i lartë për energjetikë.

Nga leximi i Vërtetimit të lëshuar nga Zyra e personelit – Komuna e Prizrenit, të datës 01.07.2016, gjykata ka konstatuar se këtu paditësi realizon të adhura mujore në shumën prej 439.41 euro.

Nga leximi i Pasqyrës bankare për paditësin G. G. të lëshuar nga Pro Credit Bank dhe NLB Prishtina, është konstatuar gjendja e llogarisë bankare të paditësit G. G.

Nga leximi i Vërtetimit të lëshuar nga zyra e personelit Komuna e Prizrenit të dt.15.03.2016, gjykata ka konstatuar se këtu paditësi G. G. realizon pagë mujore 434.00 euro (neto).

Nga leximi i Lejeqëndrimit të lëshuar nga Republika e Turqisë për të paditurën – kundërpaditësen Z. G., gjykata ka konstatuar se këtu të paditurës Z. G. ka leje të qëndrimit në Republikën e Turqisë.

Nga leximi i Dokumenteve të regjistrimit si dhe dokumentacionin për pagesën e semestrit dhe konviktit të lëshuar nga Hacettepe University – R. e Turqisë për të paditurën Z. G., gjykata ka konstatuar se këtu e paditura Z. G. është e regjistruar si studente pranë këtij Institucioni.

Nga leximi i Transaksioneve të llogarisë të lëshuar banka TEB në Prizren, për S. M., gjykata ka konstatuar se këtu përfaqësuesja ligjore e të paditurve S. M. (të cilës iu kanë besuar fëmijët nëruajtje dhe kujdes) realizon të ardhura mujore në shumë prej 714.00 euro.

Nga leximi i Aktemërimit të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, për S. M. të dt.25.04.2012 gjykata ka konstatuar se këtu përfaqësuesja ligjore e të paditurve S. M. (të cilës iu kanë besuar fëmijët nëruajtje dhe kujdes), punon pranë këtij institucioni.

Nga leximi i Vërtetimit të lëshuar në A.U.K – R.I.T në emër të B. G., të datës 16.12.2015, gjykata ka konstatuar se këtu i padituri B. G. është student i rregullt i këtij institucioni që nga muaji shtator 2015.

Nga leximi i Dëftesës së lëshuar nga “Mehmet Akif Koligj” për T. G., të datës 11.06.2015, gjykata ka konstatuar se e mitura T. G. (vajza e këtu paditësit G. G.) është nxënëse e këtij kolegji.

Nga leximi i raportit të Qendrës për Punë Sociale në Prizren, me nr.403, të datës 31.05.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se organi i kujdestarisë- Qendra për Punë Sociale – Prizren, ka zhvilluar procedurën lidhur me gjendjen materiale të palëve ndërgjyqëse, si dhe nuk kanë mundur të japin vlerësim të saktë lidhur me lartësinë e alimentacionit dhe për këtë ia kanë lënë në vendosje gjykatës.

Sipas nenit 290 par.1 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), është e paraparë se *“Prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur”*. Në nenin 290 par. 2 të këtij ligji thuhet se *“ Nëse fëmija nuk ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjeje e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri sa fëmija të arrin moshën 26 vjeç”*. Në nenin 330 par. 1 të këtij ligji parashihet se *“Detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit”*. Me nenin 331 par.1 të këtij ligji parashihet se *“Gjykata me kërkesën e paditësve apo personave të detyruar mund të ndryshoj vndimin ashtu që mund të ndërprejë, të shtoj, të zvogëlojë mbajtjen financiare ose alimentacionin i cili është përcaktuar me anë të vendimit të mëparshëm gjyqësor nëse rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar”*. Në par.2 të këtij neni parashihet se *“Kushtet të cilat mund të ndryshojnë janë nevoja personale dhe rritja e shpenzimeve të jetesës në anë të kërkuarit si dhe statusit financiar të pandehurit në anën tjetër”*.

Në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit - të kundërpaditurit është pjesërisht e bazuar, ndërsa kërkesa nga kundërpadia e të paditurve - kundërpaditësve është e pa bazë dhe si e tillë duhet të refuzohet në tërësi, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas administrimit të të gjitha provave gjykata ka vërtetuar e se këtu palët ndërgjyqëse, përkatësisht këtu paditësi me përfaqësuesen ligjore të të paditurve, në vitin 2010 kanë arritur pajtimin gjyqësor me të cilin këtu paditësi është obliguar që në emër të alimentacionit për fëmijët e mitur të paguajë nga 75 euro në muaj për secilin, të cilës marëveshje palët i janë përmbajtur në tërësi. Pas kësaj paditësi në vitin 2015 me anë të padisë ka kërkuar nga gjykata që për të miturin B. G. të zvogëlohet shuma e alimentacionit për shkak se i njëjti nuk mund të përballojë këtë shumë, ndërsa për të paditurën Z. G. të ndërpritet alimentacioni, pasi që e njëjta ka arritur moshën madhore dhe ka përfunduar shkollimin e lartë – fakultetin. Pas marrjes së padisë këtu të paditurit kanë parashtruar kundërpadi me të cilën kanë kërkuar rritjen e shumës së ushqimisë, me arsyetimin se janë rritur shpenzimet e shkollimit për të dy fëmijët (këtu të paditurit-kundërpaditësit).

Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për zvoglimin e shumës së ushqimisë gjykata ka gjetur se e njëjta është pjesërisht e bazuar dhe ka vendosur që të ndryshojë pajtimin gjyqësor në këtë pikë, duke e detyruar paditësin - të kundërpaditurin që të paguajë alimentacion nga 50.00 euro në muaj për të paditurit. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është konstatuar se paditësi - i kundërpadituri jeton në shtëpinë e tij së bashku me nënën, bashkëshorten nga martesë tjetër dhe dy fëmijët nga martesë e dytë. Poashtu është konstatuar se në këtë familje punon vetëm këtu paditësi dhe realizon të ardhura mujore nga 439.41 euro në muaj, me të cilat përveç mbajtjes së anëtarëve të familjes me të cilët jeton, kontribon edhe për pagesën e alimentacionit sipas pajtimit gjyqësor në shumë prej 150.00 euro në muaj (kjo është vërtetuar në bazë të raportit të organit të kujdestarisë dhe vërtetimit të organit punëdhënës të paditësit). Këtyre provave gjykata ia falë në tërësi besimin dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe se shuma prej 75 euro në muaj për të dy të paditurit është e papërbalueshme për këtu paditësin, pasi që e njëjta ndikon në mirëqenien e anëtarëve të tjerë të familjes së paditësit, e sidomos në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur të cilët i ka paditësi nga martesë e dytë. Këtyre

vlerësimi të gjykatës i kontribon edhe fakti se këtu të paditurit kanë arritur moshën madhore dhe mund të kontribojnë edhe në mënyra tjera në shkollimin e tyre, si dhe fakti se përfaqësuesja e të paditurve me të cilën jetojnë të paditurit realizon të ardhura më të mira mujore në shumë prej 714.00 euro (kjo e pakontestueshme nga palët). Gjithashtu në bazë të provave të administruara është konstatuar se këtu e paditura Z. G. ka arritur moshën 23 vjeqare dhe e njejta ka përfunduar edhe shkollimin e lartë-fakultetin dhe tani është në master në Turqi, e edhe ky fakt ka qenë me rëndësi për gjykatën pasi që prindërit duhet të kontribojnë në edukimin dhe ushqimin e fëmijëve edhe pas moshës 18 vjeqare nëse të njëjtit vazhdojnë shkollimin, por gjithmonë duke u bazuar në mundësitë dhe kushtet e palës e cila paguan ushqiminë, andaj dhe u vendos si në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadsisë së paditësit – të kundërpaditurit gjykata vendosi duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 290.2 të Ligjit për Familjen, pasi që prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri sa fëmija të arrijë moshën 26 vjeqare, e që në rastin konkret është vërtetuar se fëmija - e paditura Z. G. është e moshës 23 vjeqare si dhe është studente e fakultetit të mjekësisë në Turqi, që do të thotë se ekzistojë rrethanat për vazhdimin e pagesës së alimentacionit nga ana e prindit - këtu paditësit. Për këtë fakt edhe pretendimet e paditësit - të kundërpaditurit për ndërprerjen e alimentacionit për të paditurën - kundërpaditësen Z. G., gjykata i vlerësoi si të pa baza, andaj dhe vendosi si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës nga kundërpadia lidhur me rritjen e kontributit për mbajtjen finaciare - ushqiminë, gjykata të njëjtën e refuzoi si të pa bazë, pasi që me provat e administruara ka vërtetuar se nuk ka bazë për aprovimin e së njëjtës duke marrë parasysh faktin se këtu pa paditësi - i kundërpadituri nuk ka mjete për rritjen e kontributit për dhënien e ushqimisë, pasi që i njëjti është në marrëdhënie pune por realizon të ardhura mesatare që nuk mund të përballojë rritjen e kontributit për ushqiminë e fëmijëve. Këtij vlerësimi të gjykatës i kontribon edhe fakti se paditësi - i kundërpadituri ndaj të cilit kërkohet rritja e kontributit për dhënien e ushqimisë, ka krijuar edhe bashkësi të re martesore, e sidomos fakt shumë me rëndësi për gjykatën është se i njëjti nga kjo bashkësi martesore ka edhe dy fëmijë të mitur (e cila nuk është kontestuese nga palët), për të cilin ka edhe obligime finaciare shtesë lidhur me rritjen dhe edukimin e tyre, e që eventualisht rritja e kontributit - shumë për ushqimi do të ndikonte që të rrezikohej në ekzistencën e paditësit - të kundërpaditurit dhe personave që varen prej tij, e posaqërisht fëmijëve të mitur. Si fakt me rëndësi për gjykatën është edhe parimi kryesor i ushqimisë e që ka të bëjë me atë se ushqimia - kontributi çdoherë jepet për kohën e ardhshme, e që ka të bëjë me sigurimin e mjeteve të nevojshme për ekzistencë, e jo pasurim i personit për të cilin jepet kjo e drejtë. Gjithashtu është vlerësimi i gjykatës se paditësi si prind i të paditurve përmbush obligimin e tij lidhur me alimentacionin edhe me shumën e aprovuar si në pikën **II** të dispozitivit, pasi që kjo është shumë për përmbushjen e nevojave normale për edukim dhe shkollim, e nuk mund të jetë obligim real apo nevojë normale e edukimit dërgimi i tyre nëpër kolegje private, si në rastin konkret ku fëmijët nga ana e nënës me të cilën jetojnë janë dërguar në shkolla private si dhe në shkollim nëpër shtetet tjera edhe pse kjo ka mundur dhe ka pasur këso lloj drejtimesh edhe nëpër shkolla dhe universitete publike - shtetërore. Mbi bazën e të lartcekurave dhe duke marrë parasysh këto fakte gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e të paditurve - kundërpaditësve për rritjen e kontributit të paditësit për alimentacion, pasi që kjo është në kundërshtim me provat e administruara dhe mundësitë e dhënësit të alimentacionit, si dhe për faktin se një kërkesë e tillë përveç që është e pa

bazë, e njëjta është parashtruar si kundërpërgjigje ndaj padisë së paditësit, e jo që ka qenë nevojë reale për rritjen e shumës së alimentacionit.

Vlen të ceket se me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, andaj përgjatë tërë zhvillimit të procedurës, gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse.

Mbi bazën e të lartcekurave dhe duke qenë se kërkesa nga kundërpadia ka të bëjë me rritjen e kërkesës për mbajtje finaciare - ushqimi, si dhe faktit se të paditurit - kundërpaditësit nuk ka parashtruar asnjë provë bindëse, përmes të cilave do të argumentohet e drejta e tyre, edhe pse për këtë në seancën e shqyrtimit kryesor janë ftuar nga ana e gjykatës që të propozojnë prova të reja, pasi që *barra e të provuarit* lidhur me këto pretendime i ka takuar atyre, kjo gjykatë nuk mundi ta aprovojë kërkesën nga kundërpadia, respektivisht të njëjtën u deshtë që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Përfundimisht gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit është pjesërisht e bazuar , krejt kjo duke i marrë për bazë të gjitha të lartcekurat dhe dhe gjendjen finaciare të palëve ndërgjyqëse si dhe nevojat e ushqimarrësve, ndërsa kërkesa nga kundërpadi është e pa bazë, pasi që e njëjta është në kundërshtim me provat e administruara, respektivisht mundësitë e palës ndaj të cilës kërkohet rritja e shumës së ushqimisë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar në dispozitat e nenit 452.4 të LPK-së dhe nenit 347 të LFK-së, pasi që paditësi - i kundërpadituri i ka kërkuar shpenzimet, por nuk i ka specifikuar, ndërsa të paditurit - kundërpaditësit nuk i kanë kërkuar.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.743/15, datë 06.06.2016

Sekretarja juridike
Kujtesa Uka

Kryetari i trupit gjykues
Arsim Hamzaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.